



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1127/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj, dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Strahinja Spasić, kandidat për kryetarë në Komunën e Klllokotit, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe dega në Klllokot, paraqitur kundër vendimit të KQZ, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 08.12.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Hudhet si i palejuar** apeli i parashtruar nga Strahinja Spasić, kandidat për kryetarë në Komunën e Klllokotit, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe dega në Klllokot, paraqitur kundër vendimit të KQZ, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

#### A r s y e t i m

PZAP, më datë 08.12.2017, ka pranuar një apel nga Strahinja Spasić, kandidat për kryetarë në Komunën e Klllokotit, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe dega në Klllokot, me të cilën thekson se janë të pa kënaqur me vendimin e KQZ-së lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Klllokotit, për arsye se ka pasur keqpërdorime gjatë regjistrimit të votuesve për votimin përmes postës nga jashtë Kosovës, në bashkëpunim me zyrën për Kosovën dhe jo nga vetë votuesit. Andaj ka kërkuar që të verifikohet rregullsia e regjistrimit të votuesve që kanë votuar me postë nga një listë e veçantë votuesish jashtë Kosovës, nga Republika e Serbisë për Komunën e Klllokotit dhe të anulohen të gjitha votat e pranuar nëpërmjet postes, për shkak të abuzimit dhe keqpërdorimit.

Parashtruesi i ankesës si provë për të vërtetuar pretendimet e tij ka bashkangjitur: formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës dhe deklaratat e disa dëshmitarëve, listën e votuesve jashtë Kosovës për votim në Komunën e Klllokotit dhe deklaratën e kundër kandidatit për Kryetarin e Komunës së Klllokotit, Bozidar Dejanovic e dhënë në RTK2.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e apelit, gjeti se:

### **Apeli është i palejuar**

Paneli pas vlerësimit të apelit dhe pretendimeve në apel të apeluesit, konstatoi se apeli i parashtruar nga Strahinja Spasić, kandidat për kryetarë në Komunën e Klllokotit, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, ka njëjtësi subjektive, objektive dhe gjendje të njëjtë faktike me çështje e njëjtë juridike të vendosur tani në mënyrë meritore nga PZAP-i, me vendimin ZL.Anr. 1112/2017 e datës 27.11.2017.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, rezulton se kjo çështje është çështje e gjykuar (res iudicata), andaj paneli vendosi që apelin e apeluesit ta hudhë si të pa lejuar.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.1127/2017 me datën 08.12.2017



**Kryesuese e Panelit**

Gyltene Sylejmani

***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa***